



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakt i raportit përfundimtar të revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit:

Byroja për Zhvillimin e Arsimit, llogaria themelore e buxhetit (637)

### Lënda e revizionit:


Revizion i pasqyrave financiare së bashku me revizionin e pajtueshmërisë

### Qëllimi i revizionit:

A janë pasqyrat financiare të liruara nga gabime ne te gjitha aspektet materiale, si dhe aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to, a janë në përputhje me dispozitat ligjore.

### Gjendjet kyçe të identifikuara:

- Byroja nuk ka krijuar një sistem informacioni dhe një bazë të dhënash në fushën e sistemit edukativo arsimor në vend;
- që nga viti 2012, nuk është botuar revista shkencore-profesionale "Reflektime Arsimore";
- nuk është rregulluar e drejta për shfrytëzimin dhe disponimin e të gjitha objekteve të Byrosë;
- inventarizimi i pasurive, të arkëtueshme dhe detyrimeve nuk është i plotë dhe i kryer plotësisht në përputhje me aktet ligjore.



### Opinion i dhënë\*:

Kemi shprehur opinion me rezervë në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e pasqyrave financiare, si dhe për pajtueshmërinë me legjislacionin, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

### Rekomandimet kyçe:

- vendosja e një sistem informacioni me të dhëna nga fusha e arsimit;
- sigurimin e dokumentacionit për pronësinë/shfrytëzimin e objekteve të përdorura nga Byroja;
- ekzekutim i procedurave për inventarizim.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Rregullimi i rregulloreve në lidhje me përmbajtjen e sistemit të informacionit, përdorimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve, me qëllim të qasjes së integruar për sigurimin e të dhënave për sistemin arsimor.

### Vërejtjet e marra mbi draft Raportin:

Nuk janë marrë vërejtje mbi draft raportin e Revizorit të autorizuar shtetëror.

### Përgjigja ndaj vërejtjeve të marra:

/

\* pozitive, me rezervë, e pafavorshme, i përmbajtur